



Prishtinë: 22/01/2023, 14 UTC

Nr. 05/ 2023

**Koha e pikut brenda 48 orëve të ardhshme  
e martë, 24 janar 2023 - 00:00  
Vleni deri më: 25/01/2023 00:00 UTC**

Përgatitur nga:  
Dr. Bashkim Kastrati

### **Njoftimi:**

Përmasimi i kushteve të përgjithshme hidrometeorologjike gjatë 2 ditëve të fundit, ka ndikuar pozitivisht në rënien graduale të niveleve dhe prurjeve të ujit, në rrjedhat lumore në tërë vendin dhe tërheqjen graduale të ujrave, sidomos të zonave të prekura nga përmbytjet.

Sipas parashikimeve dhe llogaritjeve të IHMK\_s, (Sektorit të Hidrologjisë dhe Prognozave Hidrologjike), gjatë datës **24/01/2023**, pritet të ketë përsëri reshje shiu, fillimisht në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të vendit ku parashikohet të jenë me intensiteti të ulët deri mesatarë, të cilat gradualisht do ta përfshinë pjesën më të madhe të vendit.

Duke e pasur parasysh situatën me përmbytje të deri tanishme, sidomos në Mitrovicë, Skenderaj, Klinë etj, kjo gjendje mund ta vështirësoj edhe më tutje situatën, ngase rrjedhat ujore të këtyre zonave janë në kapacitetet e tyre maksimale, tokat sidomos ato në viset e rrafshëta janë të tejngopura me ujë dhe është limituar kapaciteti i tyre absorbues, gjegjësisht lagështia e tokës në shtresën sipërfaqësore.

### **Sqarim:**

Reshjesh më të larta se 30 l/m<sup>2</sup> brenda 12 orëve NDIKIMJNË: *Shkaktim vërshime të shpejta, përmbytje lumore, probleme në të gjitha aktivitetet e prodhimit bujqësor, probleme në trafik, rrezik për rrëshqitje dheu. Lëndime të mundshme të njerëzve dhe dëmtim të pronës.* Është e mundur dukuri lokale e shirave intensivë, përrenjve dhe erërave të forta me dëmtime të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

**Nuk parashikohet që të këtë përmbytje si ato para ca ditësh, sidomos nga lumenjtë kryesorë të vendit.**

Për më tepër përcillen:

<https://ihmk-rks.net/?page=1,4>

<https://ihmk-rks.net/?page=1,50>

Ky informacion do të përditësohet nga IHMK sipas nevojës.

<https://ihmk-rks.net>

